



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA A REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Dorezuar Prenulleno/Prodato Received/ Delivered	05-05-2021	1	viti god year
Organ / Shënia Organ / Jednina Org. Unit	SKAMENIC	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
	2200/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.215/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1601/2019 të datës 15.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën numër A.nr.252/2019 të datës 23.04.2019 të parashtruar nga ankuesi nga Fashati Korretin, Komuna e Kamenicës, në çështjen juridike "Vlerësim i punës", kundër organit të punësimit/Komuna e Kamenicës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e shqyrtimit dhe vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, më datë 05.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i filluar sipas ankesës numër A.nr.252/2019 të datës 24.04.2019 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi Përfaqësues Ligjor në Komunën e Kamenicës, me datë 24.04.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2027/2019 të regjistruar me numër A.nr.252/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me nr.8339 të datë 25.03.2019 të Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kamenicës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 25.04.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Kamenicës. Këshilli me datë 06.05.2019 ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.



Në mungesë të kuorumit për vendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi të njëjtën kohë ka hapur edhe konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 15.03.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.1601/2019, përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 23.04.2019 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka administruar këto prova: Aktgjykimin e datës 29.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigje e datës 17.06.2019; Ankesa e datës 23.04.2019 me numër protokoli 2027/2019 A.nr. 252/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi datës 25.03.2019; Ankese e datës 25.02.2019; Raportet e ankuesit: Kallëzim penal i datës 20.06.2011, Padi e datës 29.10.2015; Padi e datës 01.12.2017; Padi e datës 29.11.2017; autorizim i datës 26.08.2015; Njoftim i datës 25.09.2015; Akte vendim i datës 04.12.2018, Akte gjykim i datës 08.10.2018; Përshkrim i detyrave të punës i datës 12.11.2012, Formular i vlerësimit 2018; Formular i vlerësimit 2016; Formular i vlerësimit 2015; Vendim nr.3375 i datës 07.11.2018 Komisionit disiplinor; Vendimi Nr.26823 i datës 24.08.2018 i Komisionit përzgjedhjen e kontesteve dhe të ankesave; Aktgjykim i datës 15.01.2018; Padi e datës 18.10.2018; Certifikatë e datës 06.07.2013 Njoftim e datës 12.12.2018; Kërkesë e datës 21.12.2017; Informim i datës 24.09.2018; Informim i datës 10.10.2018; Raporti i datës 27.12.2018; Raport i datës 12.07.2018; shkresë kopje nga libri i protokoli / regjistri i lëndëve sipas viteve; Kërkesë e datës 17.01.2019; Kërkesë për rishqyrtim të vlerësimit të punës; Pliko postare e datës 23.04.2019 nr. R6910574; Përgjigje në ankese e datës 06.05.2019; Ndryshim dhe plotësim i akte emërimit i datës 02.12.2014; Akte emërimi i datës 04.02.2014; Përshkrimi i detyrave të punës; E-mail i datës 09.01.2019; E-mail i datës 10.01.2019; E-mail i datës 05.11.2019; procesverbal i datës 25.02.2019; vendimin me nr. 8339 të datë 25.03.2019 të Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave; dëshmi mbi pranimin e vendimit të datës 25.03.2019; letër përcjellje e datës 03.05.2019; E-mailin e datës 05.05.2021 të dërguar nga A.J për A.B; Kërkesën për dorëheqje me numër protokoli 02/7632 të datës 12.03.2020; Vendimin Nr.02/8095 të datës 26.08.2020 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës .

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palet, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për perfundimin e procedimit administrativ për shkak se objekti i ankesës është berë i pamundur apo i kotë, **sepse:**

Bazuar në shkresat e lendes, respektivisht Akt Emerimin nr.02/39301 të dates 02.12.2014 është konstatuar se ankuesi në kohën e parashtrimit të ankesës ka qenë i punësuar në pozitën e punës Perfaqesues Ligjor në Komunën e Kamenicës.

Kryetari i Komunës së Kamenicës, në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë, me datë 31.12.2018 ka bërë vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2018 për ankuesen me c'rast i njëjti ka konstatuar se ankuesi nuk i ka përmbush objektivat e punës dhe ka vlerësuar ankuesin me notë të përgjithshme dobët (1.057).



Ankuesi i pakënaqur me vlerësimin e rezultateve të punës me notën e përgjithshme 1.057, me datë 17.01.2018 ka parashtruar kërkesë te Kryetari i Komunës së Kamenicës, për rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2018. Kryetari i Komunës së Kamenicës, me datës 06.03.2019 ka bërë rivlerësimin e rezultateve të punës për ankuesin, dhe të njëjtin në proces të rivlerësimit e ka vlerësuar me notën e përgjithshme dobët (1.17).

Lidhur me vlerësimin e rezultateve te punës te datës 06.03.2019, ankuesi, me datë 25.02.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave. Ky i fundit me datë 25.03.2019 ka nxjerre Vendimin me nr.8339, përmes te cilit ka refuzuar si te pa bazuar ankesën e ankuesit dhe ka lenë në fuqi Formularin e vlerësimit te rezultateve të punës të datës 06.03.2019.

Ankuesi kundër Vendimin me nr.8339 të datë 25.03.2019 të Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 24.04.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave gjatë administrimit të provave të lëndës, ka gjetur se Komuna e Kamenicës, me datë 05.05.2021 ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, se ankuesi me datë 12.03.2020 ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 02/7632 përmes të cilës ka kërkuar dorëheqje të njëanshme nga pozita e Përfaqësuesit Ligjor të Komunës se Kamenicës. Dorëheqja e ankuesit është aprovuar me Vendimin Nr.02/8095 të datës 26.08.2020 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës.

Andaj, duke marr parasysh konstatimin se ankuesi nga data 26.08.2020 nuk është në marrëdhënie pune ne Komunën e Kamenicës, Kolegji vlerëson se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën A.nr.252/2019 të datës 24.04.2019, është bërë i pamundur apo i kotë, në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 ku përcaktohet se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë.*

Kështu që, pas analizimit dhe vlerësimit te të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.215/2019

Zyle Millaku-GOJNOVCI

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kamenicë;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kamenicës;
- Arkivit të KPMSHCK- së .